

SINDIKATAT NË QEVERINË KURTI



Analizë politikash





ANALIZË POLITIKASH: **SINDIKATAT NË QEVERINË KURTI**





Autore: Antoneta Zhjeçi

Data: 28 dhjetor 2022

Publikuar nga:

Qendra për Politika dhe Avokim

www.qpa-rks.org

info@qpa-rks.org

+383 (0) 38 226 530

Të drejtat e autorit © 2022. Qendra për Politika dhe Avokim. Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes së të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë elektronike, mekanike, fotokopjuese, incizuese apo tjetër, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga ana e botuesit.

Ky publikim u realizua në kuadër të projektit "Dialogu social për drejtësi sociale" implementuar nga Koalicioni për drejtësi shoqërore dhe të drejta socio-ekonomike me financim të Olof Palme International Centre dhe në mbështetje të qeverisë suedeze. Përmbajtja e kësaj analize pasqyron pikëpamjet dhe mendimet e autorit që është përgjegjës për faktimin dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara këtu. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, jo domosdoshmërisht i paraqesin ato të Olof Palme International Centre apo Qeverisë Suedeze.





Shkurtesat

ASK

Agjencia e Statistikave të Kosovës

BSPK

Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës

KES

Këshilli Ekonomiko-Social

MFPT

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

ONP

Organizata Ndërkombëtare e Punës

SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Kulturës



Përmbledhje Ekzekutive

Sindikatat si sinonim i mbrojtjes së punëtorëve luajnë një rol kyç në shoqëri, duke krijuar kushte dhe standarde më të mira për të punësuarit.

Në Kosovë organizimin sindikal e garanton Kushtetuta, ndërsa e njëjta fushë rregullohet me Ligjin Nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë të vitit 2011. Aktualisht janë të regjistruara 217 shoqata sindikale, prej të cilave 25 janë sindikata të pavarura.

Kërkesat të cilat i janë drejtuar qeverisë të Republikës së Kosovës nga sindikatat ndër vite kanë qenë të shumta në numër dhe njëkohësisht të arsyeshme në thelb. Mos adresimi i këtyre kërkesave nga qeveria e Republikës së Kosovës, ka rezultuar në bartjen e tyre nga një kryeministër tek tjetri. Madje gurthemeli për njërën nga kërkesat më të rëndësishme të sindikatave është vënë në vitin 2014 me miratimin e Ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor, mirëpo zbatimi nuk ka filluar ende, gjë që ka shkaktuar pakënaqësi tek sindikatat e sektorit publik që përfaqësojnë punëtorët e veprimtarive të ndryshme në Kosovë.

Një frymë optimiste nga sindikatat është vërejtur me ardhjen në pushtet të kryeministrit të tanishëm të Qeverisë të Republikës së Kosovës z. Kurti, i cili gjatë një takimi me përfaqësuesit sindikal në mbarëvajtjen e fushatës elektorale të vitit 2019 për Zgjedhjet Qendrore, deklaroi se sindikatat gjatë qeverisjes së tij do të gjejnë partnerin që nuk e kanë pasur asnjëherë që nga koha e pasluftës, duke premtuar kështu fuqizimin sindikal si asnjëherë më parë.

Në realitet ndodhi e kundërta, sindikatat nuk gjetën mbështetje nga qeveria aktuale që rezultoi me 4 greva të prira nga sindikatat vetëm gjatë vitit 2022.

Me këtë dokument analizohet situata e krijuar ndërmjet shoqatave sindikale dhe qeverisë së Republikës së Kosovës gjatë vitit 2022, kur qeveria udhëheqet nga një parti e majtë, Lëvizja Vetëvendosje.



Organizimi sindikal në Kosovë

Sindikatat, si mjet mbrojtës i punëtorëve, kanë një rol themelor në caktimin e ritmit në luftën kundër diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Ato bëjnë të mundur që punëtorët të luftojnë pabarazinë dhe diskriminimin në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë etnike, moshës, aftësive të kufizuara dhe/ose orientimit seksual, por jo vetëm. Çdo punonjës që është anëtarësuar në sindikatën që përfaqëson sektorin në të cilin ai/ajo punon, mbrohet nga sindikata karshi politikave që kanë tendencë ta dëmtojnë atë si punëtor/e, mirëpo jo gjithmonë sindikatat arrijnë të mbrojnë interesat dhe të drejtat e anëtarësisë së tyre siç përcaktohet me statutet e tyre.

“Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizimi të tillë”¹. Kjo liri është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i shtetit.

Në pajtueshmëri me Kushtetutën, Ligji Nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë i garanton të punësuarëve të drejtën të themelojnë organizata sindikale dhe të anëtarësohen apo të bashkohen me to.² Nga po i njëjti ligj, rrjedh detyrimi se punëdhënësi duhet të krijoj kushte dhe lehtësira të nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale, për veprim sindikal të të punësuarëve, duke përfshirë këtu lejimin e qarkullimit në mjediset e ambientit të punës, lejimin e shpërndarjes së njoftimeve apo broshurave për aktivitete sindikale, dhe krijimin e kushteve optimale për funksionimin e sindikatës si organizimi i mbledhjeve dhe takimeve të ndryshme sindikale brenda ambientit të punës.

Qëllimi thelbësor i themelimit të sindikatave “është krijimi i kushteve dhe standardeve më të mira të punës, mbrojtja e të drejtave ligjore, ekonomike, sociale dhe profesionale të të punësuarëve, si dhe avancimi i dialogut mes partnerëve social”³.

¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008). “Kushtetuta e Republikës së Kosovës”, f. 13. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). “Ligji Nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë”, f. 2. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2754>

³ Po aty, f.3.





Sipas përkufizimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), "dialogu social përfshin të gjitha llojet e negociatave dhe konsultimeve ... ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë, punëdhënësve dhe punëtorëve" për çështje me interes të përbashkët⁴. Qëllimi i dialogut social "është zgjidhja e çështjeve të rëndësishme ekonomike dhe sociale, për të inkurajuar qeverisjen e mirë, për të avancuar paqen dhe stabilitetin social dhe për të nxitur progresin ekonomik"⁵.

Dialogu social ndryshe njihet edhe si dialogu tre-palësh i cili ka për qëllim përmirësimin e kushteve dhe trajtimit të punëtorëve nëpër vendet e tyre të punës. Qeveria në dialogun tre-palësh shërben si "garantues i zbatimit të marrëveshjeve" që dalin si rezultat i dialogut social.⁶

Kërkesat të cilat i janë drejtuar qeverisë të Republikës së Kosovës nga sindikatat ndër vite kanë qenë të shumta në numër dhe njëkohësisht të arsyeshme në thelb. Mos adresimi i këtyre kërkesave nga qeveria e Republikës së Kosovës, ka rezultuar në bartjen e tyre nga një kryeministër tek tjetri. Madje gurthemeli për njërën nga kërkesat më të rëndësishme të sindikatave është vënë në vitin 2014 me miratimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, mirëpo zbatimi nuk ka filluar ende, gjë që ka shkaktuar pakënaqësi tek sindikatat që përfaqësojnë punëtorët e sektorëve të ndryshëm në Kosovë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, veçanërisht ndryshimi i nënparagrafëve të Nenit 8 që thirret në Ligjin e Sigurisë Pensionale të vitit 1983 sipas të cilit kërkohen 15 vite kontribut në skemat pensionale para 1 janarit të 1999-ës, është njëra nga kërkesat e sindikatave pasiqë sipas ligji aktual diskriminohen punonjësit të cilët para vitit 1999 janë larguar nga puna për shkak të masave të dhunshme në Kosovë atëbotë dhe si rezultat nuk kanë arritur stazhin pensional prej 15 vitesh. Me mosnjohjen e kësaj të drejte qytetarëve të Republikës së Kosovës u cenohen vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues i shtetit, prandaj ndryshimi i legjislacionit shihet si i pashmangshëm.

⁴ Organizata Ndërkombëtare e Punës (shikuar në 2022). "Dialogu Social". Marrë nga: <https://bit.ly/3W34tCM>

⁵ Organizata Ndërkombëtare e Punës (shikuar në 2022). "Dialogu Social". Marrë nga: <https://bit.ly/3W34tCM>

⁶ Ymeri, V. (2022). "Greva në arsim - grevë për mësim: Qeveria po e rrezikon lirinë për Organizim Sindikal". *Kosovo 2.0*. Marrë nga: <https://bit.ly/3WgAFCp>





Aktualisht, projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, është në fazën e diskutimit të brendshëm ndërmjet grupit punues⁷.

Një tjetër kërkesë që ka prirë grevat e sindikalistëve ka qenë edhe Projektligji për Pagat në sektorin publik me qëllim nivelizimin e pagave në këtë sektor. Edhe pse një gjë të tillë kishte tentuar të bëjë Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2019, Gjykata Kushtetuese e kishte shpallur të pavlefshëm ligjin pasiqë sipas saj ishte në kundërshtim me 11 nene të Kushtetutës. Qeveria Kurti gjatë këtij viti prezantoi Projektligjin e ri për paga në sektorin publik i cili tenton barazinë përmes nivelizimit të pagave në këtë sektor⁸, që njëkohësisht nënkupton edhe rritjen e pagave për punonjësit e sektorëve të ndryshëm që janë përfaqësuar nga sindikatat në gjithë rrjedhën e grevave të vitit 2022. Ndërsa kërkesa shtesë për pagesë prej 100 eurosh deri në miratimin e Projektligjit për paga në sektorin publik erdhi si rezultat i çmimeve të larta, si dhe si një formë për të ushtruar presion ndaj institucioneve të Republikës së Kosovës për miratimin e këtij projektligji në një të ardhme më të afërt.

Gjithsej në Kosovë janë të regjistruara 217 shoqata sindikale, prej të cilave 25 janë sindikata të pavarura,⁹ megjithatë, kushtet e punës, veçanërisht të të punësuarëve në sektorin privat nuk janë të mira, dhe të njëjtët e ndjejnë veten të pasigurt dhe të pa perspektivë në tregun e punës kosovar e si rrjedhojë edhe kërkesa për migrim është në rritje nga viti në vit.¹⁰

⁷ Bllaca, N. (2022). "Në vitet e 90-ta u larguan nga puna për shkak të masave të dhunshme, shumë qytetarëve nuk po iu njihet e drejta nga shteti për pension kontributpagues". *Betimi për Drejtësi*. Marrë nga: <https://bit.ly/3G2s9BK>

⁸ Hashani, G., & Humolli, A. (2022). "Projektligji për paga: Tendencë për nivelizim apo për ndërhyrje?". f.6. *Instituti Demokratik i Kosovës*. Marrë nga: <https://bit.ly/3YBvKxM>

⁹ Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2022). "Lista e sindikatave të regjistruara". *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=61542>

¹⁰ Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (2020). "Kosova: Trendet e Migracionit kërkojnë një qasje të re strategjike", f.13. Marrë nga: <https://bit.ly/3PuhDWZ>





Qeveria Kurti dhe sindikatat

Në realitetin socio-ekonomik të viteve të fundit, punëtorët e punëtorët detyrohen të pranojnë punë me kushte çdo herë e më të pafavorshme, e deri tek më të rrezikshmet, duke mos e bërë befases faktin që në shtatë vitet e fundit rreth 100 punëtorë kanë vdekur dhe mbi 850 të tjerë janë lënduar në vendin e tyre të punës.

Në vitin 2019, gjatë fushatës elektorale për Zgjedhjet Qendrore të këtij viti, kryeministri i tanishëm, z. Kurti në një takim me përfaqësues të sindikatave deklaroi se sindikatat, tek qeveria që do të udhëheqë ai, do të gjejnë partnerin që nuk e kanë pasur asnjëherë që nga koha e pasluftës. "Në një shtet të mirëqenies sociale, sindikatat dhe shteti janë partner për të rritur mirëqenien dhe standardin jetësor të punëtorit dhe jo konkurrenca me njëra-tjetrën. Ne duam që sindikatat të forcohen sepse të drejtat e punëtorëve mbrohen më së miri kur sindikatat janë të fuqishme, e sindikatat e fuqishme mbrojnë punëtorët nga arbitrariteti i punëdhënësit, duke përfshirë edhe shtetin si punëdhënësi"¹¹, kishte thënë ai ndër të tjera në këtë takim.

Dy vite më vonë, kërkesat e sindikalistëve nuk hasën në mirëkuptimin dhe në bashkëpunimin që u premtua gjatë fushatës elektorale të vitit 2019. Nga fillimi i zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, veçanërisht ndryshimi i nënparagrafëve të Nenit 8 që thirret në Ligjin e Sigurisë Pensionale të vitit 1983 sipas të cilit kërkohen 15 vite kontribut në skemat pensionale para 1 janarit të 1999-ës, si dhe Projektligji për Pagat në Sektorin Publik (përfshirë këtu pagesën prej 100 eurove deri në miratimin e këtij ligji), janë disa nga kërkesat kryesore të sindikatave që udhëheqen nga BSPK, për të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës është njoftuar që nga fillimi i vitit 2022.

Në muajin prill, me pjesëmarrjen e vetëm udhëheqësve të sindikatave nën ombrellën e BSPK-së, ishte organizuar një protestë në qendrën e qytetit të Prishtinës duke i'u drejtuar qeverisë së Republikës së Kosovës me thirrje për adresimin e kërkesave të tyre nën parullën "Kryeministër, realizo kërkesat tona". Për të shtuar bujën kësaj proteste, një muaj më vonë u organizua një grevë një orëshe në të gjithë sektorët e arsimit, e prirë nga SBASHK-u.

¹¹ Gazeta Blic (2022). "Kurti-Sindikatave: Tek unë, tek qeveria jonë, do të gjeni partnerin që nuk e keni pasur asnjëherë, me asnjë qeveri në këto vitet e pasluftës". Marrë nga: <https://bit.ly/3Yo9sji>





Meqenëse kërkesat e sindikalistëve nuk u adresuan deri në afatin e 28 prillit të përcaktuar nga BSPK, një protestë tjetër u organizua më 20 Maj, e cila kishte vetëm një ndryshim nga protesta e parë dhe jo në kërkesat e parashtruara, por në numrin e pjesëmarrësve në protestë, ku kjo e fundit mbledhi bashkë qindra e mijëra punonjës të sektorëve të ndryshëm që njëzëri kërkuan përmirësimin e kushteve të tyre të punës.

Për pothuajse 3 muaj, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ndërmori hapa për përmirësimin e gjendjes, apo të paktën për hapjen e diskutimeve me sindikatat që parashtruan kërkesat e lartpërmendura. Si rrjedhojë, nga 25 gushti i këtij viti, për pothuajse 5 javë, mësimdhënësit, punëtorët e administratës publike, si dhe shërbyesit civilë në institucione lokale dhe qendrore hynë në grevë, ku ndër kërkesat me bujën më të madhe mediatike ishte ajo e mbështetjes financiare prej 100 eurosh për të gjithë mësimdhënësit për të përballuar inflacionin (sipas ASK, norma e inflacionit në vend është rritur për 13% në muajin gusht, krahasuar me gushtin e vitit 2021)¹² deri në miratimin e Ligjit të Pagave, dhe njëkohësisht kërkuan edhe të përfshihen në hartimin e këtij ligji.

Për të stabilizuar gjendjen në vend, Qeveria e Republikës së Kosovës në fillim të muajit shtator prezantoi "Pakon e re të masave për përballje me inflacionin", përmes së cilës parashihej edhe ndarja prej 50 eurove në muaj për të gjithë zyrtarët publikë deri në fund të këtij viti, duke u potencuar fakti se kjo shumë parash është masë për t'u përballur me inflacionin e jo si zëvendësim për projektligjin për paga. Ndonëse një masë e tillë nuk iu përgjigj kërkesës së sindikatave dhe punonjësve të sektorëve që ata përfaqësojnë, në llogaritë e tyre bankare tashmë dy muaj këto mjete transferohen nga buxheti shtetëror.

E gjithë kjo kronologji e përplasjeve në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe sindikatave u përcjell me shumë bujë mediatike, me shumë diskutime e takime, debate e "kërcënime", me ndalesa në pagat e punëtorëve që kanë marrë pjesë në grevë, deri në fillim të muajit tetor kur edhe u vendos për ndërprerjen e grevës, ku rrjedhimisht filloi edhe viti i ri shkollor dhe ofrimi i shërbimeve nga zyrtarët publik që gjendeshin në grevë për pothuajse 5 javë.

Sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, në adresat e sindikatave të regjistruara në Kosovë, Qeveria e Republikës së Kosovës drejtohet me një njoftim/kërkesë për regjistrimin e anëtarësisë së sindikatave në platformën E-Kosova, gjë të cilën e kishte bërë të ditur paraprakisht ministri i

¹² Agjencia e Statistikave të Kosovës (2022). "Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit", f.4. Zyra e Kryeministrit, Qeveria e Republikës së Kosovës. Marrë nga: <https://bit.ly/3uM7xYa>





MFPT, z. Hekuran Murati, në gusht të këtij viti, nën arsyetimin se një gjë e tillë lehtëson punën e sindikatave, dixhitalizon procesin e mbledhjes së kuotës së anëtarësisë dhe rrjedhimisht transferimi i mjeteve në llogaritë e sindikatave bëhet më i lehtë.

Me të njëjtin sy nuk e kanë parë edhe Kryetarët dhe përfaqësuesit e sindikatave, të cilët një kërkesë të tillë e shohin si ndërhyrje të drejtpërdrejt në punën sindikale, kjo pasiqë në njoftimin e Thesarit të Kosovës thuhet se anëtarët e sindikatave duhet të regjistrohen në platformën E-Kosova si dhe të konfirmojnë të dhënat bankare nga data 15 shtator deri më datën 21 shtator. Pas kalimit të kësaj periudhe kohore, sindikatave u është ndërprerë kuota e anëtarësisë në mënyrë të njëanshme, e cila nënkupton ç'anëtarësim pa vullnetin e anëtarëve, gjë që është në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin për Organizim Sindikal dhe Standardet ndërkombëtare, të cilat rregullojnë lirin e asociimit dhe organizimit sindikal, që garantojnë dispozitat si më poshtë.

"Kushtetuta: Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.

Ligji: Sipas ligjit për organizimi sindikal, Statuti i sindikatës është akti më i lartë juridik i sindikatës, me të cilin rregullohet dhe përcaktohet fushëveprimi, parimet themelore të punës, organizimi sindikal, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve, si dhe përbërja dhe funksionimi i organeve drejtuese sindikale. Autoritetet qeveritare, nuk mund të ndërhyjnë në kufizimin e të drejtave dhe lirive sindikale ndaj të punësuarve apo të pengojnë ushtrimin e lirshëm të aktiviteteve në sindikata. Anëtarësimi në sindikatë bëhet sipas vullnetit të lirë të të punësuarit.

Standardet Ndërkombëtare (Konventa e ILO-s): Punëtorët dhe punëdhënësit, pa asnjë dallim, do të kenë të drejtën të krijojnë dhe, duke iu nënshtuar vetëm rregullave të organizatës përkatëse, të bashkohen me organizata që zgjedhin vetë pa autorizim paraprak. Autoritetet publike do të përmbahen nga çdo ndërhyrje që do të kufizonte këtë të drejtë ose do të pengonte ushtrimin e ligjshëm të saj".¹³

Këto zhvillime kanë ngritur dyshime në opinion, se premtimet e dhëna nga kryeministri i vendit z. Albin Kurti për mbështetje dhe bashkëpunimin me organizatat sindikale të Republikës

¹³ Koalicioni për Drejtësi Sociale dhe të Drejta Socio-ekonomike (2022). "Reagim: ndaj ndërhyrjes së Qeverisë në Organizimin dhe Administrimin Sindikal". *Koalicioni për Drejtësi Sociale dhe të Drejta Socio-ekonomike*. Marrë nga: <https://bit.ly/3PKNI2C>





së Kosovës ishin populiste dhe ishin përdorur si mjet për vota gjatë fushatës zgjedhore, ndërsa a do të përmirësohet marrëdhënia në mes të këtyre palëve dhe se si, mbetet të shihet në të ardhmen.





Rekomandime të politikave

Këshilli Ekonomiko-Social duhet të jetë më funksional duke marrë parasysh se është organ i nivelit kombëtar në të cilin pjesëmarrësit që përfaqësojnë të tre palët e dialogut social (të punësuarit, punëdhënësit dhe qeveria) konsultohen ndërmjet vete dhe hartojnë “propozime për organet kompetente për çështje nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikën ekonomike në Republikën e Kosovës¹⁴.” Sipas Ligjit Nr.04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, ky organ mbanë takime të rregullta të paktën një herë në muaj, ndërsa për shqyrtimin e çështjeve emergjente të dialogut social ... mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme¹⁵. Si e tillë konsiderohet greva 5 javëshe që arriti përmasat kombëtare, mirëpo KES nuk u mbledh deri 15 ditë pas fillimit të kësaj greve, duke bërë bashkë qeverinë dhe sindikalistët. Edhe pse takimi u realizua, në të nuk u arrit ndonjë marrëveshje mes palëve të pranishme.

Për të arritur këtë funksionalitet, udhërrëfyesi i mëposhtëm i liston disa nga hapat:

1. Transparenca e KES-it përmes uebfaqes dhe rrjeteve sociale. KES duhet ta përditësoj uebfaqen e tyre duke përfshirë: anëtarët, mbledhjet e mbajtura, mbledhjet e planifikuara, detajet e mbledhjeve (duke përfshirë agjendën dhe minutat e takimit), pjesëmarrjen.
2. Përmbledhjet e takimeve. Për çdo takim të mbajtur në KES duhet të hartohet një përmbledhje e takimit me pikat kryesore të diskutuara, si dhe gjithmonë të përpilohet një seksion i veçantë i dedikuar për pikat e dakorduara ose marrëveshjet e arritura nga takimi.
3. Mandati i Kryesuesit të KES-it. Mandati i Kryesuesit të KES-it është një vjeçar. Kryesuesi i KES-it është zgjedhur në tetor të vitit 2021, dhe vazhdon ta ushtrojë pozitën e Kryesuesit të KES-it ende (periudhë kohore prej 14 muajsh).
4. Përbërja e KES-it. Sipas legjislacionit në fuqi KES-i përbëhet nga 15 anëtarë të cilët përfaqësojnë interesat e Organizatave të të punësuarëve (5 përfaqësues), Organizatave

¹⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). “Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social”, f.2. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2747>

¹⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës (2011). “Ligji Nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social”, f.8. *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*. Marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2747>





të punëdhënësve (5 përfaqësues) dhe qeverisë (5 përfaqësues, respektivisht, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministri i Financave, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe Ministri i Shëndetësisë). Aktualisht në KES janë vetëm 4 përfaqësues nga qeveria për shkak të fuzionimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Ministrinë e Financave.

Adresimi i këtij rekomandimi shërben për të ngritur nivelin e funksionalizimit të KES-it, dhe ka për qëllim të transmetoj paanshmërinë e KES-it si organ apolitik dhe i pavarur, që nuk ndikohet nga grupacionet apo intereset politike që vijnë nga jashtë, si dhe rrjedhimisht të avancoj dialogun social në nivel vendi.

